



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
KOMISIONI DISIPLINOR

Nr. 5/2021 regjistri (JD)
Datë 31.05.2021

Vendim nr. 1 (JD)
Datë 09.12.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Komisioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, i përbërë nga gjyqtaret:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare

– me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike, më datë 09.12.2021, ora 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, çështjen e Juridiksionit Disiplinor nr. 5/2021, datë 31.05.2021, mbi procedimin disiplinor që i përket:

LUANDACI – Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese.

GJYQTAR HETUES: Ardian Hajdari, Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Shqyrtimi i procedimit disiplinor ndaj anëtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, z. Luan Daci.

BAZA LIGJORE: Neni 128, pika 2, germa “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni C, pika 16 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 17 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” .

KOMISIONI DISIPLINOR,

pasi shqyrtoi në tërësinë e tij procedimin disiplinor në seancë gjyqësore publike, dëgjoi gjyqtarin hetues Ardian Hajdari, gjyqtarin nën hetimin disiplinor Luan Daci, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I.

1. Me vendimin nr. 82/2017, datë 17.06.2017, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë¹, z. Luan Daci është zgjedhur gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
2. Në ngarkim të z. Luan Daci, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar regjistroi procedimin penal nr. {***} të vitit 2020, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë i Kodit Penal. Prokurorët e çështjes pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë 15.07.2020, vendosën marrjen në cilësinë e të pandehurit të z. Luan Daci, duke i njoftuar akuzën për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.
3. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 23.07.2020, njofton Gjykatën Kushtetuese se ka përfunduar hetimet për procedimin penal nr. {***} të vitit 2020 dhe – me konsideratë faktin se z. Luan Daci, sipas nenit C, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetutës, bazuar në nenin 128, paragrafi 3, germa “b” e Kushtetutës, si dhe nenin 10/ç, paragrafi 1, germa “b e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar – e informon se z. Luan Daci ka marrë statusin e të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 1 i Kodit Penal dhe i përcjell vendimin e datës 15.07.2020, të prokurorëve të çështjes “Për marrjen të pandehur dhe njoftimin e akuzës” për z. Luan Daci. Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 24.07.2020, dërgon këtë praktikë pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
4. Mbledhja e Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) pranë Gjykatës Kushtetuese, me marrjen dijeni të këtij vendimi të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në zbatim të nenit C, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të nenit 128, pika 3, germa “b”, e nenit 179, pika 7 dhe të nenit 179/b, pikat 5 dhe 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 14, datë 24.07.2020², vendosi *pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, z. Luan Daci.*
5. Pas shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të gjyqtarit të Kolegjit Luan Daci, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, ka vendosur:
 1. *Deklarimin fajtor të të pandehurit Luan Daci, për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.*
 2. *Në bazë të nenit 63 të K. Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim me kusht që i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale brenda një afati prove prej 12 muajsh.*

¹ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 133, datë 19.06.2017.

² Regjistruar në Kolegjme nr. {***} prot., datë 24.07.2020.

3. *Urdhërohet i pandehuri që në bazë të nenit 61, shkronja “a”, të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, Zyra Vendore, Tiranë, për periudhën e provës të përcaktuar në këtë vendim.*
 4. *Në bazë të nenit 190/b1, germa “ë” dhe nenit 391 të Kodit të Procedurës Penale, dokumenti kërkesë, datë 03.02.2017, drejtuar Avokatit të Popullit, për t’u emëruar në vendet vakante në institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i nënshkruar nga i pandehuri Luan Daci, të deklarohet dokument i falsifikuar.*
 5. *Dokumentet e tjera të sekuestruara me procesverbalin për sekuestrimin e sendeve të datës 01.04.2020 t’i kthehen Kuvendit [...].*
6. Pas ankimit të ushtruar nga gjyqtari i Kolegjit Luan Daci dhe mbrojtësi i tij, për ndryshimin/prishjen e këtij vendimi dhe deklarimin e pafajshëm të tij, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. {***}, datë 08.03.2021, ka vendosur *lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*
 7. Në vijim të vendimit nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përfaqësuesit e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”) nëpërmjet shkresave me nr. {***} prot., dhe nr. {***} prot., datë 25.05.2021, nxisin Kolegjin *të deklarojë përfundimin e mandatit të gjyqtarit Luan Daci nëse kërkohet duke aplikuar në mënyrë analogjike nenin 9, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe i kërkojnë të fillojë procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit Luan Daci, sipas nenit 128, pika 2, germa “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.*
 8. Në vijim të shkresave më sipër cituar të ONM-së, me kërkesë³ të Kolegjit për të qartësuar në këndvështrim formal bazën ligjore të përdorur nga vëzhguesit ndërkombëtarë për t’i drejtuar Kolegjit kërkesën për procedim disiplinor, si dhe organin pranë të cilit depozitohet kjo kërkesë, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 28.05.2021⁴, vëzhguesit e ONM-së shprehen se kërkesa e tyre e datës 25.05.2021, duhet të kuptohet kryesisht si nxitje e Kolegjit të Posaçëm të Apelit për të deklaruar përfundimin e mandatit të gjyqtarit Luan Daci, dhe së dyti dhe në mënyrë sekondare të kërkojë fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij. Baza ligjore, sipas shkresës së ONM-së gjendet në nenin B, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës⁵, në lidhje me nenin 128, pika 2, germa “b” e Kushtetutës *per analogiam* dhe nenin 17, pika 1 e ligjit të rivlerësimit⁶ *per analogiam*. ONM-ja përcakton se kërkesa duhet të konsiderohet drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 26.05.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁴ Regjistruar në Kolegjme nr. {***} prot., datë 31.05.2021.

⁵ Neni B, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “1. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit do të mbështesë procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes së gjithë procesit. Ky Operacion përfshin partnerët në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe bashkëpunimit euro-atlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Evropian”.

⁶ Neni 17, pika 1 parashikon: “1. Në rast se ka të dhëna të mjaftueshme nga burime të besueshme se anëtar i institucioneve të rivlerësimit ka kryer një shkelje disiplinore, ndaj tij fillon hetimi disiplinor. Subjektet që mund të kërkojnë fillimin e hetimit disiplinor janë: a) çdo komisioner për komisionerët; b) çdo gjyqtar për gjyqtarët e Kolegjit të Apelit; c) çdo vëzhgues ndërkombëtar për Komisionerin Publik, komisionerin dhe gjyqtarin e Kolegjit të Apelit”.

9. Kolegji, i vënë në lëvizje nëpërmjet kërkesës së ONM-së për procedim disiplinor ndaj gjyqtarit të Kolegjit Luan Daci, regjistroi çështjen e juridiksionit disiplinor (JD) nr. 5/2021, datë 31.05.2021. Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit, në përputhje me parashikimet e nenit 17, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”) dhe të nenit 18 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, organizoi shortin, sipas procesverbalit të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit, datë 01.06.2021, “Për hedhjen e shortit për zgjedhjen e gjyqtarit hetues dhe Komisionit Disiplinor”, për përcaktimin e gjyqtarit hetues dhe përbërjen e Komisionit Disiplinor që do të shqyrtonin këtë çështje disiplinore. Sipas shortit, gjyqtar hetues rezultoi gjyqtar Ardian Hajdari dhe Komisioni Disiplinor me këtë përbërje: gjyqtare Natasha Mulaj – kryesuese; gjyqtare Albana Shtylla dhe gjyqtare Ina Rama – anëtare.
10. Gjyqtari hetues, referuar materialeve të përcjella nga përfaqësuesit e ONM-së, në funksion të kërkesave të nenit 17, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. {***}, datë 04.06.2021, “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit Luan Daci”, vendosi fillimin e hetimit disiplinor ndaj anëtarit të Kolegjit, gjyqtarit Luan Daci, njoftimin me këtë vendim përfaqësuesve të ONM-së dhe Komisionit Disiplinor të ngritur pranë Kolegjit për zhvillimin e procedimit disiplinor, si dhe njoftimin/thirrjen e gjyqtarit Luan Daci për ushtrimin e së drejtës për t’u informuar, mbrojtur dhe dëgjuar.
11. Më datë 14.06.2021, gjyqtari hetues zhvilloi seancën e njohjes me aktet dhe dorëzimin e tyre gjyqtarit nën procedim disiplinor Luan Daci, provuar sipas procesverbalit⁷ të datës 14.06.2021. Po në këtë seancë, me kërkesë të gjyqtarit nën hetim disiplinor Luan Daci, gjyqtari hetues vendosi një afat 15-ditor, deri më datë 29.06.2021, për t’i garantuar të drejtën e mbrojtjes dhe përgatitjen e parashtrimeve me shkrim, si dhe paraqitjen e provave që gjyqtari nën procedim disiplinor vlerësonte të paraqiste në interes të mbrojtjes të tij.
12. Në përputhje me nenin 133 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 29.06.2021, gjyqtari hetues Ardian Hajdari administroi me anë të procesverbalit⁸ “Për dokumentimin e veprimtimit hetimor” parashtrimet dhe aktet e sjella nga personi nën hetim disiplinor, gjyqtari i Kolegjit Luan Daci. Po sipas këtij procesverbali, rezultoi se gjyqtari Luan Daci i kërkoi gjyqtarit hetues të disponojë me pezullimin e veprimeve hetimore deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes penale në ngarkim të tij nga Gjykata e Lartë, duke dorëzuar dhe rekursin e datës 20.04.2021 [plotësuar më datë 20.05.2021], drejtuar Gjykatës së Lartë kundër vendimit nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe kërkesën drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Lartë për përsheptimin e gjyqimit që lidhet me çështjen penale në ngarkim të tij.
13. Me vendimin nr. {***}, datë 06.07.2021, “Për pezullimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit Luan Daci”, gjyqtari hetues vendosi *pezullimin e hetimit disiplinor ndaj anëtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, gjyqtarit Luan Daci, për shkëlqjen disiplinore të parashikuar në nenin 128, pika 2, germa “b” e Kushtetutës deri në dhënien e vendimit nga Gjykata e Lartë mbi*

⁷ Regjistruar me nr. {***} prot., datë 14.06.2021

⁸ Regjistruar me nr. {***} prot., datë 29.06.2021.

*ankimin e gjyqtarit Luan Daci ndaj vendimit nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*

14. Pas informacionit nga burime të hapura dhe komunikimit elektronik (*e-mail*) me gjyqtarin Luan Daci, duke u njohur me faktin se Gjykata e Lartë më datë 26.10.2021, ka vendosur “Mospranimin e rekursit” të paraqitur nga gjyqtari Luan Daci, gjyqtari hetues, me vendimin nr. {***}, datë 29.10.2021, “Për rifillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit Luan Daci”, vendosi: 1. *Rifillimin e hetimit disiplinor ndaj anëtarit të Kolegjit, gjyqtarit Luan Daci.* 2. *Të njoftohet me këtë vendim gjyqtari Luan Daci, Komisioni Disiplinor i ngritur pranë Kolegjit për zhvillimin e procedimit disiplinor dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.* 3. *T’i kërkohet Gjykatës së Lartë, vënia në dispozicion të Kolegjit, e vendimit të datës 26.10.2021, në lidhje me rekursin e gjyqtarit Luan Daci.* 4. *Njoftimin/thirrjen e gjyqtar Luan Daci, ditën e hënë, datë 01.11.2021, ora 12:00, të paraqitet në ambientet e Kolegjit pranë gjyqtarit hetues, nëse dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij ligjore për t’u dëgjuar dhe mbrojtur lidhur me situatën e re faktike të përfundimit të gjykimit të çështjes së tij në Gjykatën e Lartë [...].*
15. Në vijim të vendimit për rifillimin e hetimit disiplinor, gjyqtari hetues iu drejtua Gjykatës së Lartë me kërkesën për vënien në dispozicion të vendimit të datës 26.10.2021, në ngarkim të gjyqtarit Luan Daci. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.11.2021, ka vënë në dispozicion të Kolegjit, vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. {***}, datë 26.10.2021, për *mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Luan Daci kundër vendimit nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.* Ky vendim i Gjykatës së Lartë iu përcoll gjyqtarit hetues dhe ONM-së me shkresën⁹ nr. {***} prot., datë 17.11.2021.
16. Më datë 17.11.2021, gjyqtari hetues njofton gjyqtarin nën procedim disiplinor se ka administruar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. {***}, datë 26.10.2021, duke e ftuar që deri më datë 22.11.2021, të paraqesë qëndrimin në mbrojtje të interesit të tij në lidhje me këtë vendim. Më datë 22.11.2021, nga gjyqtari nën procedim disiplinor Luan Daci u depozituan parashtrimet “Mbrojtje Juridike”¹⁰, i cili përfundimisht kërkoi që *procedimi disiplinor të pushojë për arsye se mungon shkak, veprimi i indisiplinimit të tij gjatë mandatit të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*
17. Gjyqtari hetues, në mbështetje të nenit 128, paragrafi 2, germa “b” e Kushtetutës, nenit C, pika 16 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 6 dhe nenit 17 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të vendimeve të marrë prej tij gjatë hetimit disiplinor, me vendimin nr. {***}, datë 24.11.2021, vendosi *përfundimin e procedurës hetimore në procesin disiplinor ndaj anëtarit të Kolegjit, gjyqtarit Luan Daci, duke vijuar menjëherë me hartimin e raportit përkatës mbi rezultatet e hetimit.*
18. Po në të njëjtën datë, gjyqtari hetues Ardian Hajdari i dërgoi Komisionit Disiplinor pranë Kolegjit, të shortuar për shqyrtimin e procedimit disiplinor të kësaj çështjeje, raportin mbi rezultatet e hetimit “Për shkeljen disiplinore të gjyqtarit Luan Daci”. Në këtë raport, gjyqtari hetues, ndër të tjera, shprehet se *duke u gjendur në situatën kur është paraqitur kërkesë për*

⁹ Regjistruar në Kolegjme nr. {***} prot., datë 18.11.2021.

¹⁰ Regjistruar në Kolegjme nr. {***} prot., datë 22.11.2021.

fillimin e hetimit disiplinor me shkak dënimit me vendim penal të gjyqtarit Luan Daci që gëzon statusin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, pasi u konstatua se dënimi përfundimtar i tij për kryerjen e një krimi, rezulton të jetë me vendim gjyqësor të tri shkallëve të gjykimit tashmë të formës së prerë, vendosi përfundimin e procedurës hetimore dhe hartimin e raportit mbi rezultatet e hetimit dhe dërgimin e tij për shqyrtim Komisionit Disiplinor. Gjyqtari hetues, në përfundim të procesit hetimor, ka arritur në konkluzionin se gjyqtari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese Luan Daci është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

VLERËSIMI I KOMISIONIT DISIPLINOR

II.

19. Komisioni Disiplinor pranë Kolegjit, pasi mori në shqyrtim raportin mbi rezultatet e hetimit të gjyqtarit hetues, dëgjoi parashtrimet e tij, i cili përfundimisht kërkoi *caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit Luan Daci, atë të shkarkimit nga detyra sipas parashikimeve të nenit 128, paragrafi 2, germa “b” e Kushtetutës*, pasi dëgjoi parashtrimet e gjyqtarit në procedim disiplinor Luan Daci, i cili kërkoi përfundimisht *mosdhënien e masës disiplinore ndaj tij*, sipas nenit 17, pika 6, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, *pasi nuk ekziston shkak për një masë të tillë*, çmton se procesi disiplinor i zhvilluar ndaj gjyqtarit Luan Daci është i drejtë dhe masa disiplinore e propozuar nga gjyqtari hetues është në përputhje me ligjin.
20. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes disiplinore në ngarkim të gjyqtarit të Kolegjit Luan Daci, gjyqtari hetues në raportin e paraqitur prej tij, analizoi faktin se gjyqtari i Kolegjit Luan Daci rezulton i dënuar me vendimin penal të formës së prerë nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nr. {***}, datë 08.03.2021, vendim i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, rezulton se Gjykata e Lartë ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga gjyqtari Luan Daci dhe në përfundim ka vendosur mospranimin e këtij rekursi.
21. Ndodhur në këtë situatë faktike, gjyqtari hetues, pasi ka analizuar faktin se, referuar dispozitave kushtetuese, gjyqtari i Kolegjit Luan Daci gëzon statusin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe rezulton tashmë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, në përfundim kërkoi caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 128, paragrafi 2, germa “b” e Kushtetutës.
22. Gjyqtari në procedim disiplinor, nëpërmjet parashtrimeve, pretendoi se adresimi i gjyqtarit hetues dhe ONM-së të neni 128, pika 2 e Kushtetutës, si bazë ligjore e procedimit disiplinor, dhe zbatimi i drejtpërdrejtë i kësaj dispozite kushtetuese janë të gabuar, pasi Aneksi i Kushtetutës urdhëron adresimin të ligji nr. 84/2016, nenet 16 dhe 17 të tij, po kështu zbatimin e drejtpërdrejtë të nenit 128, pika 2 e pengon neni 4, pika 3 e Kushtetutës që përcakton se: “Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe”. Po sipas gjyqtarit në procedim disiplinor, referimi të neni 128, pika 2 e Kushtetutës është i gabuar pasi gjyqtari në procedim disiplinor është anëtar i institucioneve të rivlerësimit nuk është gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, Dhomës që jep drejtësi kushtetuese. Ligjvënësi, në nenin C, pika 16 e Aneksit të Kushtetutës, anëtarin e institucionit të rivlerësimit nuk e ka

kualifikuar si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, por si subjekt të nenit C, pika 16 e Aneksit të Kushtetutës që referon në nenet 16 dhe 17 të ligjit nr. 84/2016. Nëse do të gjykohej me kriteret e nenit 128, pika 2 e Kushtetutës, atëherë gjykatë kompetente për gjykimin e tij do të ishte Gjykata Kushtetuese.

23. Në kuptim të dispozitave kushtetuese, konkretisht nenit 179/b, pika 5 që parashikon se: “Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje”, si dhe nenit C, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, që përcakton se: “Gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe mandati i tyre nuk kufizohet për shkak të moshës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj”, Komisioni Disiplinor çmon se këto dispozita kushtetuese kanë përcaktuar qartë se Kolegji i Posaçëm i Apelimit është një kolegji pranë Gjykatës Kushtetuese dhe anëtarët e tij gjatë ushtrimit të mandatit të tyre 9-vjeçar gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Gëzimi i këtij statusi për shkak të funksionit, nënkupton që në rastin objekt shqyrtimi gjyqtari në procedim disiplinor të ketë të drejta, detyrime, si dhe përgjegjësi disiplinore si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese. Në kushtet kur vetë dispozitat e Kushtetutës [neni C, pika 3 e Aneksit] i kanë atribuar gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese gjatë ushtrimit të funksionit të tij, atëherë merr kuptim zbatimi i nenit 128, pika 2, germa “b” e Kushtetutës pikërisht për shkak të gëzimit të këtij statusi. Për pasojë, referenca e përdorur nga gjyqtari hetues në këtë çështje, është e drejtë dhe në përputhje me Kushtetutën.
24. Sa më sipër, Komisioni Disiplinor ndodhet përpara faktit të deklarimit fajtor të gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit Luan Daci me një vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një krimi dhe vlerëson që aplikimi i nenit 128, pika 2, germa “b” e Kushtetutës, sipas së cilës: “2. Procesi disiplinor ndaj gjyqtarit zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos për shkarkimin e tij kur: [...] b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi”, është identifikuar saktë dhe drejt.
25. Komisioni Disiplinor, në përputhje me parashikimin e nenit 4, pika 3 e Kushtetutës, vlerëson se sanksioni në nenin 128, pika 2, germa “b” e Kushtetutës, për vetë natyrën dhe përmbajtjen e tij, është i zbatueshëm drejtpërsëdrejti, duke çmuar kështu se pretendimi i gjyqtarit në procedim disiplinor për referim të gabuar në këtë dispozitë kushtetuese, është i pabazuar. Po kështu, në zbatim të këtyre dispozitave kushtetuese të nenit 179, pika 7¹¹, si dhe parashikimeve ligjore në nenin 5, pika 3¹² dhe nenin 17 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Kolegji i Apelimit është gjykata kompetente për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, Komisioni Disiplinor çmon se pretendimi i gjyqtarit në procedim disiplinor është i pabazuar, pasi procesi disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese në të dyja kolegjet e saj, zhvillohet nga kjo gjykatë, pra është Kolegji i Posaçëm i Apelimit që ka

¹¹ Neni 179, pika 7 e Kushtetutës parashikon: “Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë [...]”.

¹² Neni 5, pika 3, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “3. Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

juridiksionin disiplinor gjatë periudhës së tij të funksionimit, për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, kur rezulton se gjyqtari është dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

26. Gjyqtari në procedim disiplinor Luan Daci, në argumentet e parashtruara para Komisionit Disiplinor, kundërshtoi hetimin dhe procedimin disiplinor të zhvilluar ndaj tij, me pretendimin se dënimi i tij në kushtet e mungesës së faktit penal, të dënimit pa ligj, është bërë në shkelje flagrante të nenit 7 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, nenit 29/1 të Kushtetutës dhe të disa dispozitave të Kodit Penal, me pasojë paligjshmërinë e vendimit penal nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vendimit nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pasi shtetasi Luan Daci nuk ka falsifikuar asnjë dokument sipas nenit 186/1 të Kodit Penal. Sipas gjyqtarit në procedim disiplinor, Gjykata e Posaçme dhe Kolegji i Gjykatës së Lartë me arbitraritet, subjektivizëm dhe njëanshmëri të dukshme kanë lejuar dhënien e fajësisë, kanë lejuar shkelje flagrante të nenit 388, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” të Kodit të Procedurës Penale.

27. Gjyqtari në procedim disiplinor pretendon se Komisioni Disiplinor ndodhet përpara dy vendimeve të formës së prerë, vendimit nr. {***}, datë 08.03.2021 dhe vendimit nr. {***}, datë 05.06.2020, të dyja vendime të dhëna nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj të njëjtit person, gjyqtarit të Kolegjit Luan Daci, të cilat kanë gjykuar të njëjtin fakt, interpretimin e qenies apo mosqenies në fuqi të një vendimi të KLD-së nr. {***}, datë 24.12.1997, i marrë para 20 viteve nga dita e aplikimit me kërkesë. Këto dy vendime, sipas këtij pretendimi, janë kontradiktore pasi fillimisht gjykata është shprehur se gjyqtari Luan Daci nuk ka kryer veprë penale, ndërsa vendimi i mëvonshëm i cili është objekt ekzekutimi nga gjyqtari në procedim disiplinor, ka kualifikuar në mënyrë krejt të ndryshme këtë veprim, si të kundërligjshëm, kualifikim ky haptazi i gabuar, në mosrespektim, shkelje dhe anashkalim me paragjykim, duke mos u shprehur për efektet e neneve 47, 48, 61 dhe 75/1/b të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjyqtari në procedim disiplinor pretendon se Gjykata e Posaçme e Apelit në këtë proces penal, dukshëm ka krijuar një situatë kontradiktore midis dy vendimeve të formës së prerë, atij nr. {***}, datë 05.06.2020 dhe nr. {***}, datë 08.03.2021. Ky fakt nuk u zgjidh në respektim të nenit 442, pika 1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale, sikurse u shkel dhe germa “a” e kësaj dispozite nga Gjykata e Lartë, e cila në mënyrë të gabuar nuk vendosi kalimin e çështjes në gjyq dhe të gjykonte sipas dispozitës së mësipërme procedurale përkatëse, prishjen e vendimit nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim.

Në kushtet e dy vendimeve kontradiktore të formës së prerë, Komisioni Disiplinor, sipas gjyqtarit në procedim disiplinor, duhet t'i drejtohet një konsulence ndërkombëtare me forume serioze juridike të karakterit evropian. Sipas gjyqtarit në procedim disiplinor, vendimi nr. {***}, datë 05.06.2020, është brenda të njëjtit proces penal dhe nuk është e drejtë të vlerësohet si një vendim gjyqësor i formës së prerë që nuk sjell pasoja, e për këtë arsye i kërkon Komisionit Disiplinor të vlerësojë juridikisht efektin e këtij vendimi gjyqësor, sikurse e ka përcaktuar dhe neni 442, pika 1, germa “ç” dhe pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.

28. Lidhur me këtë pretendim të parashtruar nga gjyqtari në procedim disiplinor, Komisioni Disiplinor arsyeton se vendimet e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk janë objekt kontrolli i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, por i gjykatës më të lartë. Në kushtet kur Gjykata e Lartë shprehu qëndrimin e saj duke mos pranuar rekursin ndaj vendimit {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për *deklarimin fajtor të Luan Daci për veprën penale të “Falsifikim i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal*, dhe kur juridiksioni i Kolegjit ndryshon, sipas Kushtetutës, Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nga juridiksioni i gjykatave penale të sistemit gjyqësor në vend, për Kolegjin ky vendim i formës së prerë është i detyrueshëm për t’u zbatuar.
29. Komisioni Disiplinor çmon se dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Kodit të Procedurës Penale nuk i kanë njohur Kolegjit të Posaçëm të Apelit e aq më pak këtij Komisioni Disiplinor vlerësimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar apo prishjen e tyre, kompetenca që neni 442 i Kodit të Procedurës Penale¹³ ia njehet vetëm Gjykatës së Lartë. Për Komisionin Disiplinor, vendimet gjyqësore të formës së prerë janë të zbatueshme dhe nuk mund të diskutohet ligjshmëria e tyre. Po kështu, për pretendimin e gjyqtarit në procedim disiplinor, sa i përket kundërshtisë së dy vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Komisioni Disiplinor vëren se vendimi i parë i cituar prej gjyqtarit është një vendim për marrje mase siguroese ndaluese dhe jo vendim i cili zgjidh themelin e çështjes. Vendimi i vetëm i cili shërben si referencë për procedimin disiplinor, është vendimi i themelit që shprehet mbi fajësinë e gjyqtarit dhe jo vendimet e dhëna në funksion të dhënies dhe përcaktimit të masës siguroese ndaluese.
30. Në mbështetje të situatës faktike të përshkruar më sipër në këtë vendim, atë të dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, të marrë ndaj një anëtari të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe në analizë të pretendimeve të ngritura prej tij në cilësinë e gjyqtarit në procedim disiplinor, se në nenin 16 të ligjit të posaçëm nr. 84/2016 mungon baza ligjore që do të legjitimonte fillimin apo procedimin disiplinor ndaj tij, me arsyetimin se dënimi me një vendim të formës së prerë nuk është parashikuar nga ky nen si shkak për përgjegjësi disiplinore, sipas vlerësimit të Komisionit Disiplinor, janë të pabazuara. Komisioni Disiplinor vlerëson se dënimi me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, për vetë natyrën e tij, përbën shkakun ligjor më të rëndë që do të vendoste gjyqtarin e Kolegjit në përgjegjësi disiplinore, e që dikton në mënyrë direkte marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
31. Në kuptim të nenit C, pika 16 e Aneksit të Kushtetutës që parashikon se: “Anëtari i Komisionit, gjyqtari i Kolegjit të Apelit dhe Komisioneri Publik mban përgjegjësi disiplinore. Rastet e

¹³ Neni 442 i Kodit të Procedurës Penale parashikon: “1. Gjykata e Lartë vendos prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim kur: a) fakti nuk parashikohet si vepër penale, vepra penale është shuar ose ndjekja penale nuk duhet të fillonte e të vazhdonte; b) shfuqizuar; c) shfuqizuar; ç) ka kontradikta midis vendimit të ankimit dhe një tjetri të mëparshëm, lidhur me të njëjtin person dhe me të njëjtën veprë penale, të dhëna nga e njëjta ose një tjetër gjykatë penale. 2. Në rastin e parashikuar nga shkronja “a” gjykata vendos pushimin e çështjes, kurse në rastin e parashikuar nga shkronja “ç” vendos që të zbatohet vendimi që ka caktuar dënimin më pak të rëndë”.

shkeljes disiplinore shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit, sipas ligjit”, ligji i posaçëm nr. 84/2016, në nenin 17, pika 6, germa “a” e tij, përcakton se në rastin e caktimit të një mase disiplinore, Komisioni Disiplinor vendos në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve. Komisioni Disiplinor çmon se vetë natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore, për shkak të dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, klasifikohen nga më të rëndat, duke e bërë gjyqtarin të papërshtatshëm për të vijuar me ushtrimin e funksionit të tij.

32. Në përfundim të sa më sipër arsyetuar, Komisioni Disiplinor, duke gjetur të pabazuara pretendimet e ngritura nga gjyqtari në procedim disiplinor Luan Daci gjatë shqyrtimit të çështjes të juridiksionit disiplinor në seancë dëgjimore publike, çmon të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesën e ONM-së për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin e gjyqtarit hetues për caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 128, paragrafi 2, germa “b” e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Disiplinor, bazuar në nenin 128, pika 2, germa “b” e Kushtetutës, nenin 17, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 105, pika 1, germa “dh” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, z. Luan Daci.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 09.12.2021.

ANËTARE

KRYESUESE

ANËTARE

Albana SHTYLLA

Natasha MULAJ

Ina RAMA

nënshkrimi

nënshkrimi

nënshkrimi